

## Fazat e zhvillimit dhe shpërblimi i fituesve

### Faza e parë: Maj - Qershor 2018

- Realizimi i shpalljes së Konkursit në faqen e Ministrisë së Kulturës ( [www.kultura.gov.al](http://www.kultura.gov.al) ) si dhe kriteret e pjesëmarrjes.
- Informimi i nxënësve dhe studentëve nga pedagogët lidhur me këtë konkurs.
- Organizimi i trajnimeve të pjesëmarrësve nga zj. Marine Blandin dhe z. Cedric Fortier, specialistë francezë e belgë të kësaj gjinie, nga Instituti “Qyteti Ndërkombëtar i Tregimeve Vizatimore dhe Imazhit” në Angulem, Francë, në periudhën 28 maj-2 qershor 2018, në qytetet Korçë, Elbasan, Shkodër, Durrës, Gjirokastrë dhe Tiranë.

### Faza e dytë: Korrik - Shtator 2018

- Realizimi i punimeve, sipas kërkesave të përcaktuara më lart.
- Dorëzimi i punimeve brenda datës 30 shtator 2018.
- Dërgimi i punimeve pranë Ministrisë së Kulturës në adresën e-mail: [novela.grafike.shqiptare@kultura.gov.al](mailto:novela.grafike.shqiptare@kultura.gov.al)

### Faza e tretë: Tetor - Nëntor 2018

- Ngritja e Jurisë Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e Drejtorit të Institutit “Qyteti Ndërkombëtar i Tregimeve Vizatimore dhe Imazhit” në Angulem, Francë, z. Pierre Lungheretti dhe të Drejtores së Institutit “Rene Goscinny”, znj. Anne Goscinny.
- Botimi i katalogut “*Legjendat Shqiptare në Novelat Grafike 4, 2018*” me punimet e përzgjedhura.
- Hapja e ekspozitës me punimet e paraqitura dhe organizimi i ceremonisë së ndarjes së çmimeve.
- Të gjithë pjesëmarrësve në konkurs do t’ju jepet nga një kopje e botimit “*Legjendat shqiptare në Novelat Grafike 4, 2018*”.

### Faza e katërt : Dhjetor 2018

- Për herë të parë, fituesi i Çmimit I do të përfitojë një bursë 15 ditore trajnimi pranë Institutit “Qyteti Ndërkombëtar i Tregimeve Vizatimore dhe Imazhit” në Angulem, Francë.  
( <http://www.citebd.org/> )

### Shpërblimi :

Çmimi I:	70.000 lekë
Çmimi II:	50.000 lekë
Çmimi III:	30.000 lekë